



NGJALLJA

Nr. 2 (145) Viti IX i botimit

SHKURT 2005

Çmimi 10 lekë

“Dita e Tolerancës”, në Akademinë Teologjike “Ngjallja e Krishtit”

Akademia Teologjike “Ngjallja e Krishtit” dallohet edhe për veprimtaritë e shumta. Ato janë të larmishme dhe zhvillohen jashtë dhe brenda mureve të shkollës, duke i përfshirë studentët si në veprimtari sociale, për të vënë në jetë njohuritë dhe parimet e vëllazërimit të krishterë të mësuara ashtu edhe për të ngritur nivelin e tyre intelektual, duke u bërë më të aftë për të përballuar kërkesat në rritje të shoqërisë.

Një veprimtari e tillë ishte edhe “Dita e Tolerancës”, një seminar studimor, që u zhvillua në mjediset e shkollës, më 15 janar. Veprimtaria ishte organizuar nga Instituti i Studimeve Ballkanike në Tiranë dhe Akademia Teologjike dhe kishte mbështetjen e Ambasadës Amerikane në vendin tonë. Merrnin pjesë përveç studentëve të Akademisë, përfaqësues nga komunitete të tjera fetare, pedagogë të Universitetit të Tiranës etj.

Veprimtaria u hap nga Drejtorja e Institutit të Studimeve Ballkanike, znj. Valentina Duka, që ishte edhe moderatorja e aktivitetit. Më pas i pari referoi drejtori i shkollës, Hirësia e Tij Ilia, që mbajti temën “Akademia Teologjike ‘Ngjallja e

Krishtit’ dhe vendi i saj në sistemin e arsimit fetar në Shqipëri” (botohet në këtë numër).

Më pas, Prof. Dr. Thoma Murzaku, pedagog i historisë së feve në Universitet foli për “Domosdoshmëria e ruajtjes dhe zhvillimit të

tolerancës fetare në Shqipërinë e sotme”. Ai theksoi: “...Eshtë një fakt i njohur historik se fetë në Shqipëri kanë bashkëjetuar dhe bashkëjetojnë në mënyrë shembullore

(vijon në faqen 7)



Çast nga veprimtaria “Dita e Tolerancës” në mjediset e Akademisë Teologjike “Ngjallja e Krishtit”, Shën Vlash - Durrës



Një qendër e re për njerëzit në nevojë

Sipas një programi të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, që filloi para pak ditësh në Tiranë, njerëzve me vështirësi të mëdha ekonomike do t’iu krijohet

mundësia që të ushqehen falas me një drekë, disa herë në javë. Kjo mensë është vendosur në kushte komode në mjediset e mëparshme (vijon në faqen 6)



Në këtë numër do të lexoni:

Faqe 2,3,4

● “Është vetëm një vegël në duart e armiqve të Kishës...”

● Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë dhe teologët e saj

● Vendi ku përgatitet e ardhmja

Faqe 5

● Rilindja e kishave në Berat, në një ekspozitë fotografike

Faqe 7,8,9

● Duhet arritur një bashkëpunim real...

● O njeri! Kush ta dha të drejtën të marrësh jetë njerëzish?

Faqe 10,11,12

● Nga Shenjtorët e muajit

● Historik i shkurtër i Patrikanës Ekumenike të Konstandinopojës

● Punimet konservuese në pikturat murale të kishës së Shën Marisë në Vrahogorranxi-Gjirokastrë

“Është vetëm një vegël në duart e armiqve të Kishës...”

Herë pas here, pikërisht, kur punët e orthodhoksisë shqiptare shkojnë mbarë, dalin në skenën e shtypit të shkruar disa pseudoklerikë për të hedhur baltë mbi figurën e madhërisë të Kryebartit të kësaj feje, Fortlumturisë së Tij, Anastasit.

Edhe kohët e fundit është shfaqur një “analist” i ri për çështjen e orthodhoksisë shqiptare, i cili në disa artikuj përpiqet t’u japë “zgjidhje” problemeve të ndërlikuara të Kishës sonë, Kulmi i këtij autori arriti në shkrimin e tij të fundit në gazetën “Koha Jonë” dt 26.01.05 me titull “Shkarkimi i Kryepiskopit, sipas legjislacionit ortodoks”, ku me tendenciozitet sugjeron që Kryepiskopi Anastas të japë dorëheqjen.

Këtu “heroi ynë i ri i orthodhoksisë” na “mëson” për kanonet kishtare në shekuj, për statutet e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë të viteve 1929, 1950, si dhe për statutin e Kishës së Greqisë fqinje, të cilën ai, sipas oreksit të tij, herë e lavdëron, herë e hedh poshtë.

Këto ai i përmend për të realizuar qëllimin përfundimtar të tij, “rrëzimin” e Fortlumturisë së Tij nga Froni i Kryepiskopit të Tiranës dhe të gjithë Shqipërisë, duke abuzuar me formulimet e copëzuara të statuteve në fjalë dhe të Rregullores së Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë të vitit 1955 (neni 36), ku theksohet: “Kryepiskopi dhe anëtarët e Sinodit, për shkak sëmundjeje kronike ose pleqërie, të cilat nuk u premtojnë të përbushin detyrat e tyre, kanë të drejtë t’i paraqesin kanonikisht dhe me shkrim dorëheqjen e tyre Sinodit të Shenjtë. Sinodi i Shenjtë ka të drejtë të shkarkojë nga detyra Kryepiskopin, sinodhikët e çdo klerik tjetër, kur konstaton se për shkak sëmundjeje kronike ose pleqërie këta nuk janë në gjendje të përbushin detyrat e tyre”.

Duke iu referuar rregullores së sipërpërmendur, natyrshëm orthodhoksët shqiptarë kanë të drejtë të shtrojnë pyetjet: A është realisht sot i sëmurë, apo i plakur Kryepiskopi Anastas?

Protestë për shkrimin shpifës ndaj Kryepiskopit tonë

(Në përgjigje të detyrueshme të shkrimit
“Shkarkimi i Kryepiskopit, sipas legjislacionit ortodoks”
në gazetën “Koha Jonë” dt. 26.01.2005)

A ekziston ndonjë raport komisioni mjekësor, që vërteton sëmundjen e Tij?

E vërteta ndriçon si dielli dhe nuk mund të errësohet nga tymnaja e Foti Cicit. Kryepiskopi Anastas gëzon shëndet të plotë. Ai është aktiv dhe dinamik, i kudondodhur në çdo skaj të Shqipërisë dhe në vende të ndryshme të mbarë botës. Shëndeti i Tij i plotë fizik dhe psikik dëshmohet me kthjelltësinë e mendimeve të Tij, me erudicionin e madh që zotëron, me bagazhin dhe përvojën shumëvjeçare si misionar i Orthodhoksisë botërore, me artikujt e panumërt që ka shkruar dhe shkruan nëpër organet e shtypit shqiptar dhe të huaj, me intervistat e qarta dhënë mediave elektronike, me praninë e Tij si kryetar, zëvendëskryetar, si lektor në podiumet e simpoziumeve e konferencave ndërfaqetare, me organizimin e drejtimin vetjak të shumë veprimtarive fetare dhe laike në Shqipëri dhe në të pesë kontinentet.

Por zotin Cici nuk e “bindin këto aftësi të shquara të këtij personaliteti të lartë botëror, të cilin Patriku i Konstandinopojës, Vartholomeu, e quan: “Bekim për Shqipërinë dhe njeri të rrallë”, ndërsa Patriku i Aleksandrisë, ish-student i Imzot Anastasit, në fund të vitit 2004 u shpreh me një sinqeritet të

veçantë: “Në misionin tim kishtar do të doja të kisha model Kryepiskopin e Shqipërisë, Imzot Anastasin”.

Foti Cici nuk mjaftohet vetëm me sëmundjen trupore të tiroideve, që kap edhe moshën rinore, prej së cilës Kryepiskopi tashmë është shëruar plotësisht, por me cinizmin e tij vazhdon të thellohet në këtë keqinformim, duke e quajtur këtë figurë të lartë të krishterimit botëror “me pamundësi psikologjike” për të bashkëpunuar me mënyra orthodhokse në kisha dhe për pasionin e Tij për të personalizuar gjithçka, që i sjell si argumente për ta detyruar Imzot Anastasin të japë dorëheqjen.

I gjori pseudoklerik Cici! Sa dritëshkurtër e paraqet veten e tij!

Kryepiskopi Anastas nuk ka asnjë arsye që të japë dorëheqje. Asnjë komision mjekësor nuk dëshmon për ndonjë sëmundje të rëndë, që të bëjë të pamundur kryerjen e detyrës së Tij dhe as autoritetet shtetërore nuk e përfillin një

sugjerim të tillë, por përkundrazi, duke respektuar Kushtetutën, ndarjen e fesë nga shteti, e mbështetin dhe e vlerësojnë kreun e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, dëshmi e së cilës është dhënia e trojeve në fshatra, qytete dhe në kryeqytetin tonë për ndërtimin e kishave orthodhokse.

Foti Cici me shkrimin e tij, përveç sa thamë më lart, akuzon Kryepiskopatën e Tiranës si një mjedis gjysmë të manipuluar dhe gjysmë të korruptuar dhe arrin deri atje sa të shprehet: “për ne orthodhoksët (e Shqipërisë) as Zoti nuk besohet si kult.”

Duket qartë se Foti Cici nuk është as klerik, as besimtar orthodhoks, por është vetëm një vegël në duart e armiqve të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, të cilët, me sa duket, i kanë premtuar fronin e Kryepiskopit të Shqipërisë.

Këtë Fron e ka merituar dhe e meriton denjësisht i Perëndizgjedhuri dhe i Gjithëpranueshmi nga populli shqiptar, Fortlumturia e Tij Anastasi

Berat më 2.2.2005

Ilia	ZAKA
Parashqevi	SAHATÇIU
Ilda	SYLARI
Milriadh	VEVEÇKA
Sotirag	MISHAXHIU
Kristaq	KOLANI
Stavri	ZHARA
Nasho	XHEKA
Xhovan	KAJANA
Milriadh	BABALLEKU
Arqile	SHYTI
Agron	GJYZARI

Mësues i Merituar	
Historiane	
Ekonomiste	
Doktor i Shkencave Mjekësore	
Bashkëpunor Shkencor	
Inxhinier Elektrik	
Drejtor Shkollë	
Inxhinier Ndërtimi	
Magjistër Farmacist	
Sipërmarrës Firme Ndërtimi	
Ekonomist	
Muzikant	

Tiranë - Agripni në Kishën “Ungjillëzimi i Hyjlindësës”

Në kishën e Ungjillëzimit në Tiranë në datën 21 janar ora 20⁰⁰ deri në orën 02⁰⁰ të ditës 22 janar u zhvillua agripni për të nderuar Apostull Timotheun dhe oshënar dëshmor Anastas Persianin.

Me këtë rast në kishë erdhën besimtarë të shumtë të moshave të ndryshme, si dhe studentë të Akademisë Teologjike të Shën Vlashit, Durrës. Këtë agripni e drejtoi Imzot Ilia i ndihmuar nga Kryesekretari i Sinodit të Shenjtë, Protopresviteri Jani Trebicka dhe shumë klerikë të tjerë.

Në kishë u bë litani me ikonën e Anastas Persianit e shoqëruar me psalmet e veçanta dhe u vendos në mes të kishës. Besimtarët pas leximit të pesë bukëve u lyen nga Imzot Ilia me vajin e Shenjtë.

Në orën 24⁰⁰ tingujt e kabanës që ushtuan në këtë natë festive lajmëruan për fillimin e Liturgjisë Hyjnore.

Me predikimin e Tij, Imzot Ilia foli për shenjtin e ditës, duke theksuar se kremtojnë ditën e emrit të Kryepiskopit Anastas dhe urojnë për shumë vjet gëzuar, të ketë jetë të gjatë për të mirën e Kishës sonë Orthodhokse. Imzot Ilia shprehu gëzimin për pjesëmarrjen e madhe në këtë Agripni dhe qëndrimin deri në fund të besimtarëve. Ai falënderoi dhe klerikët pjesëmarrës si dhe dy koret bizantine për psalmet e bukura që kënduan.

Kostandin Bozaxhiu

KISHA ORTHODHOKSE AUTOQEFALE E SHQIPËRISË DHE TEOLOGËT E SAJ

Para disa ditësh (07.01.2005) gazeta "Koha jonë" botoi një artikull me titull "Ku janë teologët shqiptarë në Kishën Autoqefale të Shqipërisë?". Ndoshta në momente të tjera këtij shkrimi mjaft fyes e denigrues për KOASH-in dhe teologët e saj mund të mos i kushtohet vëmendje e veçantë. Në fund të fundit sulmet kundër KOASH-it, kundër kreut të saj, kundër bashkëpunëtorëve të saj në përgjithësi janë kthyer tashmë në rutinë, por fakti që

i Korçës, Imzot Joani, i cili është Mitropolit i Korçës dhe anëtar i Sinodit të Shenjtë. At Kozmai dhe dhjakon Asti ofrojnë shërbimet e tyre në zyrat qendrore të KOASH-it, ku ndër të tjera koordinojnë edhe veprimtari dhe aktivitete të ndryshme të Kishës, z. Jorgo Papadhropulli është përgjegjës për gjithë veprimtarinë me Rininë Orthodhokse, që zhvillohet nën kujdesin e drejtpërdrejtë të Kryepiskopit Anastas, z. Pirro Kondili është drejtor i Liceut

Orthodhoksët që jetojnë në Shqipëri, që jetojnë me hallet dhe problemet e këtij vendi, që marrin pjesë aktivisht në jetën kishtarë të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë e që vazhdojnë të mbeten të patundur në traditat e besimin e të parëve, mund t'i përgjigjen fare mirë pyetjes cinike që ngre artikullshkruesi "i vetëmërguar".

artikulli i lartpërmendur u botua pa u marrë parasysh as monstroziteti i shpifjeve që përmbahen në të, as identiteti i vërtetë i artikullshkruesit, i cili përdor pseudonim (edhe pse për ne është i njohur), na detyron t'i drejtohem gazetës suaj, të cilën e çmojmë dhe e vlerësojmë si tribunë të fjalës së lirë dhe të dialogut demokratik në Shqipëri.

Orthodhoksët që jetojnë në Shqipëri, që jetojnë me hallet dhe problemet e këtij vendi, që marrin pjesë aktivisht në jetën kishtarë të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë e që vazhdojnë të mbeten të patundur në traditat e besimin e të parëve, mund t'i përgjigjen fare mirë pyetjes cinike që ngre artikullshkruesi "i vetëmërguar". Ata i njohin më mirë se kushdo teologët e tyre, e dinë se cilët janë, ku janë e ku jetojnë. Së pari, Mitropolit

Kishtar "Kryqi i Nderuar" në Gjirokastrë. Teologë të tjerë, të cilët kanë studiuar në vende të ndryshme, bëjnë pjesë në stafin mësimdhënës të Akademisë Teologjike "Ngjallja e Krishtit" në Durrës, drejtor i së cilës është një tjetër teolog me origjinë nga Korça, i ardhur nga Kisha Orthodhokse e Amerikës posaçërisht për të ndihmuar Kishën tonë, ndryshe nga ç'bëjnë artikullshkruesi në fjalë dhe modelet për imitim që na sugjeron, të cilët kanë braktisur Kishën e tyre për të shijuar nga afër luksin dhe konfortet e Evropës, Kanadasë apo Amerikës. Teologë janë edhe ata studentë që, edhe pse mund të studiojnë në këto momente jashtë për teologji, në rastin më të parë kthehen në atdhe për të ndihmuar Kishën e tyre, për të bërë katekizëm, për të dhënë ndihmesën e

(vijon në faqen 4)

Vendi ku përgatitet e ardhmja

Akademia Teologjike "Ngjallja e Krishtit" në Shën Vlash, është një nga veprat më të mëdha dhe realizimi i një prej objektivave kryesore të Fortlumturisë së Tij, Kryepiskopit Anastas. Kjo Akademi përbën bazën e themelit të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë dhe kjo për vetë faktin se në të përgatitet e ardhmja e Orthodhoksisë shqiptare.

Akademia Teologjike i ka fillimet e saj 13 vjet më parë, në shkurt të vitit 1992, kur në kampin e punëtorëve "Niko Bellojani" në Durrës nisën studimet rreth 45 studentë nga zona të ndryshme të vendit. Kushtet në të cilat kryhej studimi ishin mjaft të vështira dhe godina në tërësi ishte pothuajse e pabanueshme.

Ishte bërë një kërkesë për dhënien e një trualli për ndërtimin e shkollës, por nuk u mor asnjë përgjigje. Prandaj u vendos që ajo të bëhej në vendin e lirë, në territorin e manastirit të Shën Vlashit. Në këtë vend kishin mbetur vetëm gërmadhat e ndërtesave të mëparshme të shkatërruara mizorisht në vitin 1967 nga sistemi ekzistues dhe disa qiparisa të moçëm si simbole të vetme të ekzistencës së manastirit.

Më 19 nëntor të vitit 1994, Kryepiskopi Anastas, vuri gurin e themelit në kishën e shenjtë të Shën Vlashit. Në të njëjtin vend dhe në të njëjtën ditë, ai bekoj dhe fillimin e punimeve për ngritjen e mjedisëve të shkollës Teologjike Hieratike.

Akademia Teologjike "Ngjallja e Krishtit" hyri në ndërtesën e saj të re në datën 1 tetor 1996 dhe në datën 17 tetor, Kryepiskopi Anastas kreu shërbesën e bekimit me ajazëm. Ky objekt zë një sipërfaqe prej 2800 m², ku përfshihen: konvikti i djemve për 80 studentë, holli, kafeneja, salla e ngrënies, biblioteka, sallat e mësimt, salla e informatikës, kisha e shkollës, si dhe mjedisë të tjera për studentët dhe personelin në kushte të një standardi të lartë.

Në tetor të vitit 1997, për herë të parë vajzat u bënë pjesë e Akademisë Teologjike. Kjo ishte një nismë e vështirë, por që u mbështet shumë nga Fortlum-

turia e Tij, i cili e sheh shumë me vlerë rolin e gruas në Kishë. Për ato ekziston një konvikt i veçantë pranë manastirit të Shën Vlashit.

Që nga viti 1992 deri në vitin 2002, kanë mbaruar studimet në këtë akademi rreth 200 studentë, 128 prej të cilëve janë klerikë; 20 janë katekistë që udhëtojnë kudo në Shqipëri për të përhapur Fjalën e Perëndisë; 11 punojnë në Kryepiskopatë, në departamente të ndryshme dhe disa studiojnë jashtë vendit për një përgatitje më të lartë në shërbim të Kishës Orthodhokse të Shqipërisë.

Kisha jonë ka gjithmonë nevojë për njerëz me zell dhe shpirt të palodhur. Ky është dhe duhet të jetë qëllimi kryesor i të gjithë atyre që studiojnë në këtë akademi: Të afrohen më afër Perëndisë, të mësojnë sa më shumë që të jetë e mundur, të punojnë në Kishë me durim dhe dashuri, duke dhënë fruta të ndryshme të marra dhuratë nga Perëndia duke shërbyer si klerikë, dhjakonë, ikonografë, katekistë, predikues, drejtues të grupeve rinore etj.

Akademia Teologjike "Ngjallja e Krishtit" në Shën Vlash, i ka dyert e hapura për të gjithë ata që kanë brenda tyre dashurinë e Perëndisë, si dhe dëshirën për t'i dhënë Kishës sa më shumë, atje ku ajo ka nevojë.



KISHA ORTHODHOKSE AUTOQEFALE E SHQIPËRISË DHE TEOLOGËT E SAJ

(vijon nga faqja 3)

tyre në mbarëvajtjen e kampin-geve verore etj., madje jo rrallë me sakrificë të shumta e në dëm të studimeve që kryejnë.

Është me të vërtetë qesharake që personi që fshihet nën pseudonimin Kristo Muzaka këshillon teologët e KOASH-it të marrin shembull nga një farë Foti Cici, me origjinë nga Nivica e Sarandës, një person me moral të dyshimtë, i cili me shumë vështirësi arriti të merrte diplomën e teologut në Universitetin e Athinës (pas shtatë e kusur vjetësh), ku studioi me ndihmën e vazhdueshme financiare që i ofroi shteti grek. Karriera e tij nisi pas lirimt nga burgu për krime ordinere në vitin 1989, për të kaluar pastaj në shtetin fqinj, në Greqi me emër dhe pashaportë të falsifikuar (emri i tij i vërtetë ishte Fatmir dhe jo Foti), duke u prezantuar si vorio-epirot që kishte vuajtur në burgjet e monizmit për shkak të bindjeve të tij greke e orthodhokse.

Në gjysmën e dytë të viteve '90, vite mjaft kritike për Kishën tonë, refuzoi në mënyrë kategorike të ofronte shërbimet e tij, duke u përpjekur ndër kohë, edhe pse pa sukses, të hironisej si prift në Kishën e Greqisë. Në vazhdim kaloi në Amerikë, ku përpjekjet e tij për t'u hironisur në Kishën Orthodhokse Greke të Amerikës si dhe në Kryepiskopatën Orthodhokse Shqiptare të Amerikës dështuan edhe njëherë tjetër. Më në fund ia arriti qëllimit të bindte një episkop të OCA-s në Kanada, me pretekstin se do të ndihmonte emigrantët shqiptarë të besimit orthodhoks që jetonin në këtë vend. Pas pak vitesh, në pamundësi për të fituar besimin e emigrantëve të atjeshëm, njoftoi mbylljen pa afat të objekteve të kultit, në të cilat shërbente si famullitar, pa pasur kurajon që t'u shpjegonte besimtarëve shkaqet e vërteta të largimit. Tashmë dihet se ky bari "besnik" i grigjës shqiptare të Kanadasë i ofron shërbimet e tij si prift Komunitetit Orthodhoks Grek (Greek Orthodox Community) në provincën e *Surrey and Fraser Valley*, komunitet i cili varet drejtpërdrejt nga Patrikana

Ekumenike e Konstandinopojës (Për më tepër shih Kalendarin e Patrikanës Ekumenike 2005, fq. 956). Ashtu si mjaft herë në të kaluarën, emri i këtij shqiptari të "flaktë", i shndërruar në mënyrë të pamoralshme nga Fatmir në Fotios, pastaj prapë në Fatmir, pastaj prapë në Foti, tani së fundi shndërronhet përsëri në Fotios Cici (kështu është shkruar në kalendarin e sipërpërmendur të vitit 2005).

Nga ky njeri, pra, jeta dhe vepra e të cilit nuk kanë asgjë të përbashkët me moralin, zellin, përpjekjet dhe vetëmohimin që demonstrojnë sot teologët e Kishës së Shqipërisë në të mirë të KOASH-it dhe shoqërisë shqiptare

Nga ky njeri, pra, jeta dhe vepra e të cilit nuk kanë asgjë të përbashkët me moralin, zellin, përpjekjet dhe vetëmohimin që demonstrojnë sot teologët e Kishës së Shqipërisë në të mirë të KOASH-it dhe shoqërisë shqiptare në përgjithësi, na kërkon autori i artikullit të mësipërm të marrim shembull. Këtë njeri përpiqen të na servirin si model interesa dhe qarqe të errëta, që fshihen pas këtij artikulli denigrues e keqdashës.

në përgjithësi, na kërkon autori i artikullit të mësipërm të marrim shembull. Këtë njeri përpiqen të na servirin si model interesa dhe qarqe të errëta, që fshihen pas këtij artikulli denigrues e keqdashës.

Bëhet qartë tashmë se teologët e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë nuk kanë nevojë të marrin shembull nga "teologu" Foti Cici, madje as nga vëllai i tij, Artem Cici, i cili edhe ai ka studiuar në Greqi për teologji, duke refuzuar edhe ai nga ana e tij të kthet në atdhe për të ndihmuar Kishën mëmë. Tashmë ai shërben si psalt në një nga kishat e Selanikut dhe është martuar me një shtetase greke, nga një familje e pasur e këtij qyteti.

Të dhënat e mësipërme nuk janë të njohura vetëm për teologët nga Shqipëria, të cilët e kanë njohur Foti Cicin gjatë studimeve të tyre në Athinë, por edhe për ata, të cilët i ofrojnë tribunë përçartjeve të tij. Është me të vërtetë për të ardhur keq kur shikon artikuj që

botohen me emrin e tij, apo me pseudonime të ndryshme (për të krijuar përshtypjen në Shqipëri se ka mjaft përkrahës), në një kohë që autori nuk ka kurrfarë kredibiliteti moral e profesional e gjeputrat që shkruan nuk ofrojnë asgjë tjetër veç urrejtje, përçarje e shpifje pa doganë.

Të gjithë ata që kanë marrë mundimin e kanë lexuar ato që shkruan herë pas here Foti Cici do të bien dakord të paktën në dy gjëra: Së pari, në artikujt e tij dhe në temat që trajton nuk mund të gjesh kurrë një propozim serioz konstruktiv, apo ndonjë frazë falënderimi e mirënjohjeje, veçse kritika keqdashëse e arrogante për të

gjithë e për gjithçka si dhe shumë vrer. Së dyti, në artikujt e tij nuk mund të gjesh asnjë konkluzion, që të kuptojë edhe lexuesi se ç'kërkon të thotë e cili është qëndrimi i tij ndaj problemit që trajton.

Për pasojë nuk është vlere e atyre që shkruan ky "gjakatës i të gjithëve" që e bëjnë "të famshëm", por interesa të errëta, të cilave u vjen për shtat denigrimi i Kishës Orthodhokse të Shqipërisë dhe i veprës fisnike që kryen për gati pesëmbëdhjetë vjet me radhë Kryepiskopi Anastas për ringjalljen e saj nga hiri i së kaluarës. Sado që disave mund të mos u vijë mirë nga ky realitet, prania e tij në Kishën tonë përbën me të vërtetë një bekim të veçantë. Në qoftë se shtojmë edhe faktin që ky njeri nuk është i pranishëm prej shumë vitesh në vendin e vet, qoftë edhe si turist i thjeshtë, pra nuk është njohës i realitetit kishtar shqiptar, atëherë konstatimi se ky njeri është kthyer në një vegël të verbër interesash antiorthodhokse bëhet akoma më bindës.

Siç theksuam edhe në fillim të këtij shkrimi, në një rast tjetër ndoshta nuk do të ishte e nevojshme që të merrnim mundimin t'i përgjigjeshim një artikulli si i lartpërmenduri. Akuzat që përmendëm deri në këtë moment janë kthyer tashmë për ne orthodhoksët në një rutinë të përditshme. Ajo që me të vërtetë nuk e kemi hasur qysh prej epokës së propagandës komuniste të Enver Hoxhës dhe të Sigurimit famëkeq është paragrafi i fundit i artikullit në fjalë, i cili bën fjalë për vëllanë, shokun dhe kolegun tonë të paharruar, teologun Maksi Çuko, i cili ndërroi jetë para pak kohësh. Pa marrë parasysh dhimbjen tonë, pa treguar as respektin më të vogël për dhimbjen e familjarëve të tij, artikullshkruesi drejton shigjetat e tij të helmëta ndaj "grekeve", siç i quan ai, të Kishës sonë, të cilët i akuzon drejtpërdrejt se janë ata që e kanë helmuar. Formulimi i një akuze të tillë të pamoralshme e pa precedent për një shoqëri të civilizuar, ashtu si dhe adoptimi i saj i drejtpërdrejtë apo i tërthortë, siç mund të jetë p.sh. fare mirë kjo e fundit botimi i një artikulli të tillë, përbën padyshim fyerje për KOASH-in, por edhe për mijëra besimtarë me origjinë greke, pjesëtarë të saj, të cilët jetojnë në këtë vend e punojnë natë e ditë për parimin e saj. Mjaft kuadro të Kishës, teologë të denjë, klerikë të denjë, bashkëpunëtorë të denjë të saj i përkasin pikërisht kësaj popullsie. Është e padrejtë dhe e pandershme që në epokën në të cilën jetojmë, të riciklohen akuza që na sjellin ndër mend kohë të tjera. Akuza të tilla nuk nderojnë askënd. Nuk nderojnë sigurisht as gazetën që mori mundimin t'i botojë pa asnjë lloj rezerve. Prandaj besojmë se, gjithsesi, kjo çështje duhet të marrë rrugën e drejtësisë.

**Jorgo Papadhropulli,
Pirro Kondili, Spiro Papa
teologë në Kishën
Orthodhokse Autoqefale
të Shqipërisë
(Botuar në gazetën "Sot")**

Rilindja e kishave në Berat, në një ekspozitë fotografike

Berati përfaqëson një kulturë të lashtë 2400-vjeçare, të një jetese të pandërprerë qytetare. Cilësitë gjeografike dhe historia e kësaj treve, rilindja e krishterimit në një vend tradicional me besimtarë të përkushtuar, përcillen edhe përmes imazhit të fiksuar në celuloid në një ekspozitë fotografike.

Për ta bërë të gjallë në kujtesë atmosferën e këtij qyteti, mbresat e një të kaluarë me shumë ngjarje historike, fotografi i njohur Dhimitër Topi, në bashkëpunim me fotografin Eshref Vrioni, hapën në mesin e muajit janar një ekspozitë fotografike në mjediset e qendrës kulturore "Lindart", në Tiranë.

"Berati, ura me gjashtë harqe" titullohej kjo ekspozitë, e cila mbloshi për dhjetë ditë me radhë besimtarë dhe artdashës kryeqytetas.

Pikërisht rreth 15 vjet më parë, pas mbylljes së kishave nga regjimi i kaluar ateist, u hap më 12 dhjetor 1990 kisha e Shën Spiridhonit në këtë qytet. Këtë moment dhe të tjera imazhe, fotografi beratas Dhimitër Topi i fiksoi në aparatën e tij fotografik, për t'i shfaqur pas disa vitesh në një ekspozitë të kësaj natyre.


"Duke pasur hob fotografinë, mendova që këto ngjarje t'i ruaja në celuloid. Hapja e kishës, kambanat e saj të para dhe pastaj festat dhe të kremtet e mëdha, siç janë ato të Shën Vasilit të Madh, Uji i Bekuar etj., ishin ngjarje me një histori shumë të veçantë, të cilat qytetarët e Beratit nuk mund t'i harrojnë" - tha për gazetën fotografi Dhimitër Topi.

Fragmente nga shërbesat fetare, pagëzimet, pamje nga kisha të shumta të qytetit u sollën në këtë ekspozitë me një veçori historike, duke ngjallur interes tek vizitorët.

Ndër 60 punimet e ekspozitës u paraqitën edhe pamje nga ura karakteristike e Goricës, një ndërtim i vitit 1780 me harqe prej guri të bardhë. Gjithashtu paraqiteshin edhe pamje të ndryshme nga qyteti, si dhe shtëpitë në një vendosje karakteristike.

Përmes kësaj ekspozite u evidentua mesazhi i autorëve, të cilët synuan të zgjonin ndërgjegjen qytetare, që këto vlera shumë të çmuara të Beratit të mos humbasin.

Isidor Koti



Disa nga pamjet e ekspozitës

E kam njohur Dhimitrin ditët e ngazëllyera kur u hap sërish kisha në Tiranë. Vinte nga Berati me një numër fotografish të freskëta nga etapa nismëtare e asaj ringjalljeje: Hapja e kishës së Shën Spiridhonit në Goricë, që është lagjja e tij. E ndihmova ta vendosim këtë ekspozitë të vogël në hyrje të kishës. Mund ta them se ato gra e fëmijë me qirin në duar, turma e besimtarëve që mbushte rrugët e kishat, të rinjtë me ekzapterihë duke i prirur procesionit, qenë si një mesazh i ngrohtë, si një llambadhë e madhe

stafete, që na vinte nga qyteti i lashtë i traditës sonë.

Më vonë, të dy bashkë ndërmorëm një udhëtim në Greqi, për t'i ekspozuar edhe atje këto fotografi kaq unike - kishat e rrënuara nga njeriu i verbuar dhe ringjallja e tyre mbas dekadash. Qysh atë kohë gjej tek miqësia e Mitit, tek tregimet e tij të gjalla nga jeta e pasur e tij, ngrohtësinë e një besimtari të vërtetë, që ka gjetur frymëzimin e tij më të mirë tek binomi Berat-Kishat e tij.

Lekë Tasi

"Shën Matrona" e Dishnicës.

Dishnica është një fshat me tradita shekullore në besimin kishtar orthodhoks. Në këtë fshat shumë afër Korçës, ndodhen mbi 12 kisha, të cilat ishin shkatërruar gjatë periudhës që lamë pas. Dhe ja tani, brenda një periudhe të shkurtër 14 vjeçare, ato po rindërtohen. Disa nga këto kisha janë rindërtuar e po vazhdojnë të ndërtohen me kontributin e besimtarëve të shumtë të fshatit Dishnicë, qytetarëve korçarë, me ndihmën e pakursyer të Mitropolisë së Korçës. Korça, qytet me tradita shekullore në kulturë, në breza ka të kultivuar turizmin malor. Grupe të shumta qytetarësh, të të gjitha moshave, si në dimër ashtu dhe në verë frekuentojnë pikat më të bukura të vargmaleve të Moravës. Këto grupe të shumta amatorësh të maleve, në gjurmët e të parëve të tyre, kanë edhe besimin kishtar orthodhoks. Kudo në pikat turistike të Moravës, këta qytetarë të nderuar, merren edhe me vepra bamirësie: rindërtojnë çezmat e prishura, çezma të reja, dhe kudo në vargmalet e Mo-

ravës, po rindërtojnë kishat e shkatërruara.

Një grup i tillë qytetar korçar, admirues të turizmit malor, është grupi me Stavrin, Mishelin, Pandin, Vangjushin, Ilon, Llazon, e shumë grupe të tjera. Kohët e fundit, ky grup, me moshë mbi 55 vjeç, rindërtoi kishën e Shën Matronës në Dishnicë, krejtësisht me kontributin e tyre; Kisha e Shën Matronës, e bukur, e shumë mbresëlënëse, ngrihet në një majë turistike mbi Dishnicë, që dominon Fushën e Korçës.

Një grup tjetër qytetarësh dhe amatorësh të turizmit malor është edhe ai i Dhimitër Kondakçiu, të cilët bashkë me fshatarët, në këtë fshat, kanë rindërtuar nga themelet kishat: "Shën Dhimitri", "Shën e Premte", "Kozma e Damian" (Satrivaçin) të fshatit Dishnicë. Një grup tjetër qytetarësh, amatorë të maleve, rindërtuan në pyllin mbi Dishnicë "Shën Matronën". Ditën e mërkurë, më 20 tetor, u bë mesha e shenjtë, në kishën e rindërtuar të Shën Matronës, në Dishnicë. Qindra e qindra

besimtarë nga Korça e fshatrat morrën pjesë në këtë meshë të drejtuar nga Atë Andrea Zhurka. "Shën Matrona" e fshatit të Dishnicës, është një kishë unikalë dhe e vetme në Shqipëri. Shën Matrona ka jetuar në kohëra shumë të vjetra dhe ishte shërbëtore në një familje hebreje, në Selanik. Matrona plotësonte detyrat e saj si e krishterë dhe ndërmjet detyrave të saj, kishte edhe shoqërimin e zonjës së saj në sinagogën hebreje dhe menjëherë shkonte në kishën e krishterë. Kur u mor vesh kjo gjë e zonja e rrahu atë dhe e torturoi deri sa dha shpirtin e saj tek Perëndia.

"Shën Matrona" e fshatit Dishnicë nuk dihet ekzaktësisht se kur është ngritur, por me siguri është shumë-shumë e vjetër, në atë majë tek këto relike mbi Dishnicë. Në përfundim vlen të theksoj, se korçarët besimtarë, turistë, amatorë të malit, edhe në fshatra të tjera e pika të tjera të Moravës, kanë ringritur kishat e shkatërruara.

Thoma Piluri

“Zoti është mes nesh”

Kudo, në dhimbjet tona, e ndjejmë Perëndinë më pranë. Zhvillojmë me Të biseda të brendshme, intime dhe prekëse. I drejtohem Atij për të kryer përherë punë të dobishme, për të lehtësuar sado pak barrën e njëri-tjetrit.

Në disa raste, detyrohem të flasim për disa nga këto vepra, në mënyrë që të tërheqim sa më shumë njerëz në shërbime dashurie.

Gra besimtare të Kishës, të organizuara nga punonjëset e Zyrës së Grave të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë zhvillojnë vazhdimisht vepra të tilla plot besim, dashuri e përkushtim. Vizitat dhe ndihma tek të sëmurët, të varfrit dhe të moshuarit janë bërë qendra e vëmendjes së aktivitetit. “Duke hyrë në biseda me ta, kemi zbuluar vuajtjet, dhimbjet por edhe

mënyrat si t’i ndodhemi sa më pranë”, - shprehen ato. Gra të ndryshme kanë shërbyer vullnetarisht në pastrim, gatim, pazar dhe shërbime mjekësore (kontakt me mjekun, blerje ilaçesh) etj.

Të shumta janë rastet e vizitave në spitale, tek persona të varfër, të cilët i kanë mbështetur me ndihma financiare për të kryer operacione të ndryshme kirurgjikale.

“Në prag të Krishtlindjeve u prezantuam me një familje shumë të varfër nevojtare. Nëna 38-vjeçare e sëmurë dhe që kujdesej për 3 fëmijë (6, 9, 13 vjeç), siguronte bukën e gojës duke kërkuar lëmoshë në rrugë, ndërkohë që burri është në burg. Familja banonte prej 6-7 vjetësh në kushte shumë të vështira strehimi, brenda një barake pa dysheme e çati, por të mbuluar me

plastmasë e llamarinë. Për këtë arsye gruaja kishte bërë 3 operacione në trup dhe vuan nga astma.

Nën kujdesin e Fortlumturisë së Tij, Kryepiskopit Anastas, i gjetëm një strehë të re banimi derisa burri të dalë nga burgu.”

Çdo muaj Zyra e Grave ofron një mbështetje ekonomike e shpirtërore për rreth 100-150 familje në nevojë.

Vetëm për festën e Krishtlindjeve dhe Vitin e Ri u ndihmuan afërsisht 800 nevojtarë.

E rëndësishme gjithashtu është hapja e qendrës së re ditore për të varfrit. Aktualisht në të mund të hanë drekë 3 herë në javë 30-40 të varfër (të vetmuar, të sëmurë, të moshuar etj). Inagurimi i saj u bë më datën 18 janar, ditën e festimit të Shën Athanasit. At Jani Trebicka

bëri bekimin e parë të tryezës, duke përcjellë njëkohësisht edhe përsëritjet e nxehta të Kryepiskopit Anastas. Drejtimi i këtij aktiviteti bëhet nga çifti orthodhoks misionar amerikan George dhe Polina Rassel në bashkëpunim me Zyrën e Grave të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë. Një punë e rëndësishme i del punonjësve të Zyrës për të përzgjedhur personat nevojtarë dhe për të aktivizuar punën vullnetare të grave që shërbejnë gjatë ushqimit.

Për të gjitha përpjekjet falënderojmë Perëndinë e fortë të gjithëfuqishëm dhe i lutemi t’i bekojë punët tona për lavdi të emrit të Tij të Shenjtë. Amin.

Rajmonda Shqevi

Një qendër e re për njerëzit në nevojë

(vijon nga faqja 1)

të Institutit Profesional “Frymë Dashurie”, në rrugën “Qemal Stafaj”. Si fillim kjo do të bëhet tri herë në javë (të martave, të enjteve dhe të shtunave). Në krye të personelit të kësaj qendre do të jetë çifti misionar amerikan, Xhorxh dhe Polina Rassel. Veprimtaria e mensës filloi me shërbesën e bekimit të ujit, që u krye nga Kryesekretari i Sinodit të Shenjtë të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, Protopresviter Jani Trebicka.

Për momentin, në mensë po trajtohen rreth 30 persona, të cilët ushqehen me një meny të pasur



Pamje e mensës

dhe të larmishme. Mensa është e furnizuar me të gjitha pajisjet e nevojshme. Gjithashtu, një automjet shërben për ata që, për shkak të largësisë, kanë vështirësi për ta frekuentuar.

Kryesisht njerëzit që do të punojnë në mensë janë vullnetarë, përveç kuzhinieres dhe ndihmëses, ku një rol të veçantë luajnë edhe veprimtaret e Grupit të Grave Orthodhokse. Ishte po grupi i grave, që duke njohur shumë familje dhe individë në gjendje shumë të vështirë, ku kanë dhënë ndihma të ndryshme, dha informacion për personat që mund të trajtoheshin sipas këtij programi.

Festë e veçantë me të rinjtë orthodhoksë të Tiranës

Tradita e bukur e ndarjes së kekut të Shën Vasilit mbledhi në fund të janarit me dhjetëra të rinj në shtëpinë e re të rinisë orthodhokse në Tiranë. Festa u përshkua nga një atmosferë e ngrohtë dhe u përcoll me entuziazëm deri në fund kur u shpallën edhe fituesit e monedhës së fshehur brenda kekut karakteristik, që përgatitet sipas traditës çdo fillim viti.

Të parët që morën pjesë në këtë festë të veçantë ishin mësimitdhënësit e kurseve të gjuhëve të huaja, kompjuterit, muzikës etj. Në një festë të veçantë të përgatitur nga Zyra Kombëtare e Rinisë

Orthodhokse, ata zbuluan “njeriun me fat” të vitit 2005.

E njëjta festë, por me protagonistë të tjerë, u përgatit edhe për stafin e revistës “Kambanat”. Ndarja e kekut përcaktoi në fund të takimit edhe fituesin.

Por festa më e madhe ishte rezervuar në fund të muajit janar, në një takim, ku përveç aspektit shpirtëror, spikatën edhe bisedat në grup të të rinjve, programi artistik, skeçet etj. Drejtori i Programeve Rinore të Kishës sonë z. Jorgo Papadhopulli, pasi prezantoi programin e kësaj dite të veçantë ftoi Motër Thelogjinë për të folur rreth

tre Hierarkëve të Mëdhenj të Kishës (Shën Vasilin të Madh, Shën Grigor Theologut dhe Shën Joan Gojartit). Më pas të rinjtë u ndanë në grupe për t’u njohur me njëri-tjetrin si dhe për të zhvilluar diskutime e lojëra të ndryshme. Gjithashtu të pranishëm ishin edhe të rinj, të cilët merrnin pjesë për herë të parë në një nga aktivitetet e shumta që organizon Kisha jonë. Atyre iu bë i ditur programi i aktiviteteve të përditshme dhe periodike që organizon rinia orthodhokse e Tiranës, duke marrë në këtë mënyrë një ftesë për t’u bërë pjesë e saj.

IK

“Dita e Tolerancës”, në Akademinë Teologjike “Ngjallja e Krishtit”

(vijon nga faqja 1)

re. Populli shqiptar, i ndarë në disa fe, nuk ka njohur asnjëherë luftëra të brendshme, qoftë edhe konflikte në shkallë krahinore, me karakter fetar... Kjo dukuri karakteristike dhe e rrallë është arritur si rezultat i përpjekjeve të vetë shqiptarëve, për të cilën kanë merita të veçanta si personalitetet drejtuese të komuniteteve fetare ashtu edhe ideologët e udhëheqësit e popullit shqiptar për emancipimin e tij politik e kulturor nga të tre besimet.”

Shefi i katedrës së Gazetarisë, Prof. Asoc. Dr. Bashkim Gjergji, mbajti temën “Toleranca fetare në median e sotme shqiptare”. Ai shprehu mendimin e tij, se media e sotme shqiptare “...në trajtimin e çështjes së besimeve fetare, në atë të tolerancës, të mirëkuptimit dhe të bashkëjetesës harmonike mes komuniteteve të ndryshme, media në përgjithësi ka ditur të ruajë një pozicion të vet të artë: ajo ka mbështetur linjën karakteristike të popullit tonë në shekuj... Ajo e ka quajtur kurdoherë tolerancën fetare një vlerë të madhe, ruajtja e së cilës është interes kombëtar prioritar...”

Pastaj, pedagogu i Akademisë Teologjike, z. Vlash Plepi, foli për “Ideologjitë fetare dhe toleranca”.

Tema të tilla, të cilat kanë të bëjnë me tolerancën, dialogun ndër-fetar, mbarëvajtjen ndërmjet nje-



rëzve, komuniteteve, popujve apo grupimeve të ndryshme të cilët kanë ndërmjet tyre dallime ideologjike, besimi apo të çfarëdo emërtimi tjetër që ato mund të marrin, janë kaq shumë të rëndësishme apo dhe të domosdoshme për një bashkekzistencë paqësore dhe mirëkuptim kaq shumë të dëshiruar nga mbarë njerëzimi anekënd botës....

...Për rrjedhojë, përgatitja e duhur e feve të njerëzimit për zbutjen dhe kapërcimin e fenomeneve të sëmurra të fanatizmit dhe të zemërngushtësisë fetare është kultivimi i frymës së tolerancës dhe dialogut paqësor, i cili zvogëlon largësitë, krijon predispozitat për respekt reciprok dhe për bashkekzistencë paqësore ndërmjet popujve. Bashkekzistencën paqësore na e imponon fryma ekumenike, e cila vazhdon të zhvillohet me gjithë vështirësitë që

ekzistojnë sot. Kjo është një botë, në të cilën duhet të marrin pjesë shoqëritë e të gjithë popujve dhe të të gjitha feve...

...Harmonia dhe toleranca fetare mund të vihet re shumë lehtë këtu në Shqipëri. Toleranca në besim, është një vlerë që ne e ruajmë gjatë shekujve, duke u qëndruar sulmeve të shumta përçarëse. Shqiptarët erdhën ndër shekuj si popull pluri-konfesional, ku feja e mëparshme qëndronte në një kohë që një fe tjetër e re hynte, dhe kështu deri në ditët e sotme. Shqiptarët dhe në veçanti durrsakët (ku unë jetoj) kanë ruajtur një traditë të bukur urimi të festave të besimtarëve të përkatësisë tjetër fetare. Kështu të krishterët bëjnë vizita për t'i uruar Bajramin myslimanëve dhe anasjelltas, myslimanët i urojnë të krishterëve Pashkët, Krishtlindjet etj.

Pra, nuk është thjesht një bashkëjetesë e shtrënguar, por më tepër se kaq. Fatmirësisht kjo traditë e hershme shqiptare është sot në harmoni të plotë me standardet demokratike perëndimore të lirisë së besimit të gjithkujt e respektit ndaj besimit të tjetrit, veçanërisht e spikatur në një demokraci të avancuar, multietnike e plurikonfesionale...

I fundit e mori fjalën studenti Thoma Shkira, i cili trajtoi temën “Fryma e tolerancës në mjediset e Akademisë Teologjike”. Ne studentët e Akademisë, tha ai, nuk mjaftohemi të jemi tolerantë vetëm këtu në Akademi dhe brenda komunitetit, por këtë frymë do ta shprehim edhe përballë personave jashtë kishës, sepse është një dhuratë që i bën mirë gjithë njerëzimit”.

Pas një pushimi, të pranishmit drejtuan pyetje, bënë vërejtje dhe diskutuan në mënyrë të gjallë rreth temave të trajtuara, të cilat u vlerësuan për seriozitetin dhe nivelin e tyre. Temat dhe diskutimet u vlerësuan edhe nga Imzot Ilia dhe znj. Duka.

Një atmosferë të veçantë krijoi edhe programi i hartuar nga studentët e Akademisë. Ai përfshinte një paraqitje mjaft interesante të veprimtarisë së shkollës që nga krijimi i saj, të shoqëruar edhe me diapozitiva, si dhe një program i pasur artistik me këngë fetare dhe tradicionale.

Korresp. i “Ngjalljes”

Fjala e Hirësi Ilias në “Ditën e tolerancës”



Të nderuar të ftuar, pedagogë dhe studentë!

...Është një gëzim i madh t'ju uroj mirëseardhjen në Akademinë Teologjike “Ngjallja e Krishtit”, në ambientin historik të Manastirit të hirshëm të Shën Vlashit. Ky vend ka qenë i respektuar nga të gjithë shqiptarët, pa dallim feje, që kryenin pelegrinazhet e tyre me shpresëtar duke kërkuar shërim dhe hir për plagët e shumëllojshme të jetës. Vrulli i ideologjisë antifetare nuk e la manastirin të paprekur. Në vitin 1991, me heqjen e nenit kushtetues ateist erdhi në Shqipëri Krye-

piskopi Anastas, i cili iu drejtua kodrës së Shën Vlashit. Midis rrënimeve të manastirit dhe të Kishës së Shën Vlashit, ai u gjunjëzua duke iu lutur Perëndisë për ngjalljen e Kishës Orthodhokse në Shqipëri, për ripërtëritjen e besimit në këtë vend të mjeruar për dekada; i lutej Perëndisë t'i paraqiste njerëz të devotshëm, të denjë për shërbimin kishtar. Ishte pikërisht në këtë vend që Perëndia bekoj ringritjen e Manastirit bashkë me një shtesë, Akademinë Teologjike, për përgatitjen shpirtërore, mendore, arsimore, shoqërore, patriotike dhe psikologjike

të kuadrove që nevojiteshin për restaurimin dhe mbarëvajtjen e besimit.

Kjo akademi, u themelua nga Kryepiskopi Anastas me ndihmën e paçmuar të teologëve të mbijetuar të vitit 1991, të të ndjerëve Dhimiter Beduli dhe Theodor Papapavli, gjithashtu dhe me ndihmën e disa murgjve nga Mali Athos, që erdhën në këtë punë të shenjtë me gatishmërinë e tyre të nxitur nga dashuria për Krishtin, për Kishën e tij të Shenjtë, por edhe, le të theksojmë, nga dashuria për popullin shqiptar. Gjatë historisë së saj 12-vjeçare

(vijon në faqen 8)

Duhet arritur një bashkëpunim real..

Duhet arritur një bashkëpunim real...

(vijon nga faqja 7)

kanë shërbyer edhe pedagogët misionarë të ardhur nga jashtë shtetit, që kanë punuar dhe po punojnë dhe madje disa së bashku me familjet e tyre, për dobinë dhe hirin e Akademisë. Me keqardhje ju them se vetëm një misionar ka ardhur nga diaspora shqiptare e Amerikës për të ndihmuar Akademinë ose Kishën me një afat të gjatë. Misionarët e huaj që kanë shërbyer dhe shërbejnë me ndershmëri, kanë fituar admirimin e studentëve, sepse kanë treguar dashuri për Shqipërinë dhe kanë dhënë kontributin e tyre maksimal me sakrificë dhe ndërgjegjshmëri.

Gjithashtu studentët e diplomuar shërbejnë sot në Kishë si priftërinj, katekistë dhe drejtues të shërbimeve të ndryshme kishtarë. Veçanërisht duhet vënë në dukje se disa nga studentët e diplomuar kanë kryer studimet teologjike në universitetet evropiane dhe janë kthyer që të drejtojnë e të japin mësim në Akademi. Lejomëni të them se masa e suksesit është kurdoherë pikërisht kjo, kur studentët rikthehen në shkollën e tyre si pedagogë dhe profesorë, për të siguruar vazhdimësinë e qëllimit të saj dhe rritjen e aftësive të saj në të ardhmen.

Kjo Akademi është e Shqipërisë dhe në shërbim të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë. Kjo Akademi është një nder i pazëvendësueshëm për kombin dhe popullin shqiptar në përgjithësi dhe në veçanti për Kishën dhe besimtarët Orthodhoksë.

Për saktësi, veprimtaria e sotme "Dita e tolerancës" ka pasojë edukative të cilësisë së parë, e cila nuk kufizohet vetëm në arritjet arsimore, por shtrihet në vlerat e përmbushjes së tyre, si përshembull: paqja, parimet e përbashkëta, të drejtat e njeriut, demokracia, toleranca dhe mirëkuptimi i ndërsjellë.

Ne besojmë se, edukimi i çdo qytetari vazhdon gjatë gjithë jetës së tij dhe ndërton shoqërinë civile brenda një kulture të civilizuar dhe unikale. Ky edukim kontribuon në mbrojtjen e të drejtave bazë të të gjithëve.



Çast nga

diskutimet

në fund të

veprimtarisë

"Dita e Tolerancës"



Kur një shoqëri pranon si një detyrë respektimin e zakoneve të ndryshme të popullit të saj, duke përfshirë edhe ato të besimit, qofshin këto të maxhorancës apo të minorancës, atëherë kjo shoqëri gjen rrugën e dinjitetit të njeriut dhe dëshirën e vërtetë për bashkëjetesë. Njëkohësisht kjo shoqëri i shmang "politikën së identitetit" dhe pushton "politikën e interesit" dhe bazohet në dashamirësinë ndërmjet qytetarëve që pranojnë bashkëpunim dhe dialog midis bashkësive për të arritur mirëqenien e të gjithëve.

Për më tej, në këtë shoqëri zhvillohet një frymë e përbashkët e njerëzimit që kërkon përmirësimin e njerëzimit në përgjithësi. Fillon nga parimi i vlerës së paqes, së tolerancës, së përgjegjësisë për të gjetur zgjidhjet e problemeve bashkëkohore. E domosdoshme është rivendosja e lidhjeve midis etikës dhe mirëqenies. Gjithashtu paraqitet marrëdhënia e mirëdashjes njerëzore me dëshirën e të vepruarit drejtësisht.

Në kontekstin e Shqipërisë së sotme mund të konsiderojmë që feja është e ndër-këmbeshme me kulturën. Shpeshherë kjo krijon një përshtypje të gabuar.

Ndërgjegjja e shqiptarit pranon larminë e vet në shumë fusha: vendbanimi, besimi, gjuhë, muzikë, kostume, etj. Toleranca dhe bashkëjetesa si parime pranojnë kuptimin e shumëllojshmërinë dhe udhëzojnë në zbatimin e drejtësisë, lirisë dhe demokracisë.

Komunitetet fetare gëzojnë një frymë të përbashkët tolerance, mirëkuptimi dhe bashkëjetese. Historia dëshmon për këtë fenomen që bota e çmon. Por a na mjafton kaq? Si është e mundur që bashkësitë fetare të kenë një bashkëpunim real? Flasin me një zë kur kërcënohen nderi apo të drejtat e njeriut prej tyre? Ofendimet, padrejtësitë, fyerjet, vjedhjet dhe grabitjet e monumenteve fetare, dëmtimet, shpifjet, akuzat dhe lajmet e rreme nuk kanë bërë që të dëgjohet asnjë zë nga fetarët apo politikanët.

Toleranca fetare nuk është një perde mbrapa së cilës fshihemi. Toleranca nuk është pasive, por duhet të bëhet veprimprurëse që vërteton se këtu në Shqipëri dhimbja e një bashkësie është dhimbje e të gjithëve. Padrejtësia e bërë në kuriz të një bashkësie është padrejtësi për të gjithë.

Në dialogun ndër-fetar le të diskutohet, jo sharje dhe kritika, por mënyra e harmonisë midis komu-

niteteve dhe bashkëpunimi për hir të të gjithëve.

Po e mbyll këtë mesazh përshëndetje duke cituar mendimin e Fortlurturisë së Tij Imzot Anastasit, i cili thotë: "A duhet të bashkëpunojmë me persona që vijnë nga besime dhe ideologji të tjera?"

Kur qëllimi është t'i shërbejmë gjithë familjes njerëzore duke nxitur drejtësinë, barazinë, lirinë, respektin për personalitetin njerëzor, paqen dhe mirëqenien e popullit dhe kombit të dikujt, përgjigjja jonë duhet të jetë qartazi 'Po'."

Le të jetë ky citim përshëndetje dhe bekimi i Kryepiskopit për ne në këtë "Ditë të Tolerancës". Faleminderit!

Fjalim i Hirësisë së Tij,
Imzot Ilias,
mbajtur më 15 janar 2005
në aktivitetin
"Dita e Tolerancës",
në Akademinë Teologjike
"Ngjallja e Krishtit"

Adresat e faqeve në Internet

dhe ajo e E-mail-it,

të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë,

janë:

Internet: www.orthodoxalbania.org

E-mail: orthchal@orthodoxalbania.org

O njeri! Kush ta dha të drejtën të marrësh jetë njerëzish?

nga
Joan SHOLLA

Para disa kohësh në lajme, dëgjuam se 21 veta u mbytën dhe 7 të tjerë humbën në detin Jon. Këta njerëz përpiqeshin të shkonin në Itali ku do të punonin. Njerëzit e familjes sapo morën vesh lajmin filluan të qanin dhe të dëshpëroheshin. Shumë të tjerë që dëgjuan për tragjedinë ndjejnë dhembje për këta njerëz. Për të gjithë shqiptarët ky ishte një lajm shumë i hidhur, i cili tronditi të vegjël e të mëdhenj. Ishin 21 veta ku disa prej tyre sapo kishin filluar ta shijonin jetën, disa të tjerë sapo ishin fejuar dhe disa të tjerë kishin fëmijë.

Por, a keni dëgjuar që çdo ditë në Shqipëri vdesin mbi 50 veta, të cilëve nuk u jepet, mundësia të qajnë. Mos ju duket e pakuptueshme kjo pyetje që bëra? Po, po mbi 50 fetuse dhe fëmijë vdesin në Shqipëri nga nënat dhe baballarët e tyre. Kjo gjë ndodh nga mbrojtësi dhe ndihmësi kryesor i fëmijës, e cila është nëna e tij. Njëri prind ose të dy së bashku vrasin fëmijën e tyre pa iu dridhur dora, pra nëna aborton. Mendoni njëherë që shumë nga këta prindër u merrzin për 21 njerëzit që u mbytën në det, por me gjakftohtësi të habitshme bëjnë një nënshkrim të plotë për vrasjen e bijve të tyre. Shumë vajza, të cilat nuk u bënë nëna, qanë, sepse disa njerëz u mbytën nga një vdekje natyrore, por pa derdhur një pikë loti vranë fëmijën e tyre. Shumë e shumë njerëz e kryen këtë krim pa e vënë në punë ndërgjegjen. Shumë e shumë fëmijë u mbytën pa lindur. Mendoni pak që sa e sa fëmijë vdesin pa dëgjuar zërin e nënës.

Pse ndodh aborti? Një nga arsyet e abortimit të fëmijëve nga nënat e tyre është turpi. Vajzat e reja, të cilat kryejnë marrëdhënie para martesës mendojnë se është më mirë të abortojnë se sa të turpërohen në sy të botës. Ajo, pasi kryen një mëkat, përpiket ta fshehtë këtë mëkat me një vrasje. Ato që abortojnë thonë ose mendojnë se janë të lira të bëjnë me veten e tyre çfarë të duan. Atyre u duket më mirë të vrasin një fetus ose një foshnjë që ka filluar të marrë for-

mat e njeriut sesa të turpërohen ose të tallen me të. Ato harrojnë që fetusit që kanë në bark i është formuar zemra dhe pjesë të tjera të trupit. Sa e shëmtuar, një nënë që vret! Zoti ka dhënë pushtetin mbi lindjen e jetës. Nëna është e destinuar të falë dashurinë, por bën të kundërtën, vret. Ky është një krim i pafytyrë i një plage të thellë të shoqërisë sonë. Atyre do t'u vinte keq, do t'u dhimbte në qoftë se do të shihnin një fëmijë të shtypur nga ndonjë automjet, por nuk do t'u vinte keq për fëmijën e tyre, i cili s'ka për të parë automjete.

Një arsye tjetër që shumë gra kryejnë abort është planifikimi familjar. Çifti mendon: "Përse duhet të kemi fëmijë, kur ne sapo u martuam, le ta abortojmë këtë fë-

një automjet. Ata thonë ose mendojnë: "Një fëmijë duhet të rritet dhe që të rritet, do rroba, ushqime të ndryshme dhe në qoftë se do të sëmuret, kërkon ilaçe e shumë të tjera. Pra, më mirë për ne - thonë ata - është të kemi një makinë që nuk kërkon një kujdes të tillë siç do një fëmijë."

Një arsye tjetër që i çon njerëzit drejt abortit është edhe karriera. Shumë e shumë gra mendojnë se është më mirë të abortojnë, se sa të largohen nga puna për një vit. Ato mendojnë: "Është më mirë të abortoj, se sa të më shpëtojë ky rast i mirë për karrierë". Ato mbështeten në thënien "Kur të vjen rasti, shfrytëzoje atë".

Por çfarë thotë shteti për abortin? Aborti në Shqipëri u lejua li-

gullt e prindërve të tij. Mjekët e lejojnë abortin deri në muajin e tretë. Më pas ata thonë se një abort pas muajit të tretë do të ketë më shumë pasoja për nënën. Dhe përsëri e lejojnë abortin edhe pas muajit të gjashtë në qoftë se nëna ka probleme serioze shëndetësore. Ligjet e lejojnë abortin sepse thonë, që krijesa në barkun e nënës nuk është njeri.

Çfarë thotë Kisha Orthodhokse për abortin? Ajo thotë që ne nuk kemi të drejtë të shkatërrojmë jetën tonë, sepse ajo është një dhuratë nga Perëndia. Akoma më shumë ne s'kemi të drejtë që të marrim jetën e një embrioni ose të një fetusit, i cili është në barkun e nënës.

Në qoftë se ne mendojmë që trupi ynë është banesa e Shpirtit të Shenjtë, ne nuk mëkatojmë vetëm duke vrarë një fëmijë, por mëkatojmë kundër Shpirtit të Shenjtë. Sinodi i 6-të Ekumenik vendosi përse i përket abortit: *Ajo grua që merr ilaçe për të vrarë embrionin ose fetusin, pra të abortojë, përbën subjekt që ka kryer një vrasje dhe merren masa ndaj saj njëjloj si merren masa ndaj çdo njeriu që vret.*

Por shumë njerëz mund të thonë: Ai është thjesht një embrion ose fetus. A ekziston shpirti në krijesën, e cila ndodhet në barkun e nënës? Le të sjellim ndër mend historinë e takimit të Elisabetës me Hyjlindësen, ku Joani 6 muaj kërcëu në barkun e Elisabetës. Shpirti ekziston në trupin e krijesës jo vetëm kur ai është 6 muaj. Ne të krishterët besojmë se Fjala erdhi dhe zuri vend në trupin e Hyjlindëses, që në momentin e ungjillëzimit. Pra, ne besojmë se shpirti vjen tek njeriu që në momentin e ngjizjes.

Pra, të mos vrasim me duart tona fëmijën tonë, sepse nuk kemi të drejtë të vrasim veten tonë, aq më tepër të marrim jetën e fëmijës sonë të palindur. Të kemi kujdes që të mos mbysim në "Detin Jon" një fëmijë, i cili s'ka lindur akoma. Le të kemi parasysh porosinë e gjashtë që Zoti i dha Moisiut: "Mos vrit!" Pra, le t'i japim mundësinë një fëmijë të pafajshëm të jetojë jetën e tij, ashtu si edhe ne e jetojmë tonën e deri tani!



Ikona e Abortit

mijë." Mendoni pak në qoftë se nëna e Shën Vasilit të Madh do të kishte menduar si një grua, ku baza e së cilës është planifikimi familjar, atëherë nuk do të kishim Shën Vasil të Madh. Shumë vepra nuk do të shkruheshin dhe Kisha nuk do të kishte një kolos të madh.

Një arsye tjetër që shumë gra abortojnë është gjendja e keqe e familjes. Njëherë bisedova me një çift, të cilët kishin 10 vjet që ishin martuar. Gjatë bisedës kuptova se ata kishin abortuar një fëmijë. Kur i pyeta pse e abortuan u përgjigjën se s'kishin mundësi ta mbanin atë fëmijë për arsye ekonomike. Atëherë i pyeta se përse nuk e vrisni djalin që e keni në klasë të parë, sepse edhe tani keni probleme ekonomike? Ata panë njëri-tjetrin me sy. Shumë çifte thonë se më mirë të abortojmë, se sa të kemi një fëmijë, i cili harxhon më shumë se

gjërisht në vitin 1995. Konsulentët e abortit u thonë nënave që të mos abortojnë, sepse do të kenë probleme, si: depresioni i të ndjerit fajtor, çrregullim në ngrënie, mundësia e marrjes së infeksioneve të ndryshme, do t'u nevojitet ndihma psikike, si dhe mundësia e moslindjes. Por ka edhe disa raste kur mjekët u këshillojnë nënave që të abortojnë, sepse nuk rrezikohet shëndeti i fëmijës, por edhe shëndeti i tyre. Por duhet të veprojmë me kujdes në raste kur mjekët na këshillojnë që të abortojmë fëmijën tonë. Në qoftë se nëna e Kryepiskopit Anastas do të pranonte këshillën e mjekëve, kur i thanë se duhet të abortonte, sepse jo vetëm fëmija rrezikon, por edhe ti, sot nuk do të kishim Kryepiskopin Anastas midis nesh. Pra, nuk do të kishim bariun e Kishës sonë. Mund të ishte një kujtesë e mje-

Nga Shenjtorët e muajit

Stamati, Joani, Nikolla, neomartirë (3 shkurt)



U ushtruan (martirizuan) më 1822. Stamati dhe Joani, përkatësisht 18 dhe 22 vjeç ishin nga Specces, ishull në jug të Atikës (që banohet kryesisht nga arvanitas), fëmijë të Theodor Gjinit dhe Anezës.

Dikur, siç po lundronin së bashku me pesë të tjerë për punë tregtie, erëra të fuqishme e degdisën anijen e tyre në Çemë (Krinë), në bregun perëndimor të Turqisë.

Të frikësuar, sepse agarinët ishin të egërsuar nga revolucioni grek i vitit 1821, takuan një të krishterë dhe i dhanë para që t'u sillte çfarë u nevojitej për riparimin e anijes së tyre. Por, ai solli turqit! Ata vranë dy nga detarët e sprovuar nëpër stuhi, që tentuan të iknin, kapën vëllezërit dhe kapitenin plak, Nikollën. Të tjerët u arratisën me not.

Më 26 janar robërit i shpunë tek pashai i ishullit Hios, që ndodhet përballë. Pashai urdhëroi dhe i pre-

në kokën Nikollës, i cili i qetë dhe i palëkundur nuk pranonte të konvertohej.

Sundimtari u premtoi shpërbllim dy vartësve të tij, në qoftë se ata do të arrinin t'i shkëpusnin të dy të burgosurit nga Krishti. Për një javë rresht ata u përpoqën t'i joshnin të dy të rinjtë me dhurata apo t'i trembnin me ndëshkime, por më kot. Pashai i bezditur, tha se më lehtë pritet koka e kaurit, sesa këmbëngulja kokëfortë e tij.

Të rinjtë paranjohën me zbulim fundin e tyre dhe ua bënë të ditur edhe të burgosurve që ishin bashkë me ta. Gjithashtu, i dërguan një rrëfim të shkruar episkopit të Hios dhe kërkuan Falënderimin Hyjnor, të cilin arriti t'ua dërgojë me një grua. U kunguan mbasi u lutën pothuaj gjithë natën.

Në mëngjes çdo gjë që kishin e dhanë lëmshë, para se t'i dënonin, meqenëse shpallën se pranorin të copëtohen ende për hir të besimit të tyre. Joani për një çast u frikësua nga shpatat e zhveshura enkas, por e mbështeti Stamati (greqisht = ndalues), sa që së bashku deklarorin se po vdisnin për Jisuin. Kështu, i therrën në afërsi të therrtores së Hios.

Pas tri ditësh trupat e pavarrosur i hodhën në det, por deti i nxori diku në breg, përveç kokës së Joanit. Ato i mblodhi një i krishterë, i cili enkas mbikqyrte atë pjesë të bregut, ku punonte si regjës lëkurësh.

Agathia, martire (5 shkurt)

Për arsye të sojit të saj prej arkondi, pasurisë, bukurisë dhe karakterit shkëlqente në atdheun e saj, në Katania të Sicilisë.

Pas vdekjes, siç duket, të prindërve të saj idhujtarë, kur ishte 15 vjeç, u arrestua në kohë të Decios (249-251), nga sundimtari i shthurrur, që vinte nga një fis jo shumë i njohur në Sicili. Ai kishte si qëllim ta shkëpuste nga Krishti

e ta merrte për grua dhe kështu të shijonte gjithë të mirat e saj.

Përpjekjet e tij për ta bërë për vete, duke i bërë shumë lajka e premtime dështuan. Vajza e kundërshtoi, prandaj e dorëzoi tek një grua të përdalë. Për një muaj rresht e torturonte ose e joshte, por nuk arriti ta thyente rezistencën e saj.

Atëherë sundimtari urdhëroi dhe e mbyllën në burg, ku e reja

shkoi me dëshirë. Ditën tjetër e varën, e digjin dhe e kamxhikonin pa mëshirë. Pastaj i prenë gjinjtë, por në mesnatë në burg erdhi brenda një ndriçim i mbinatyrshëm, apostulli Petro (29 qershor) dhe e shëroi.

Të nesërmen, meqenëse martirja vazhdonte të mos pranonte t'u sakrifikonte perëndive, e tërhoqën zvarrë mbi copa tullash të mprehta dhe gjemba hekuri dhe më pas e hodhën në zjarr. Kur po lutej, një tërmet shkatërrues frikësoi bashkëqytetarët e saj, të cilët mësynë në ndërtesën qeveritare dhe këmbëngulën që të ndalojnë torturat! E

çuan përsëri në burg, ku duke u lutur dorëzoi vërtet frymën.

E varrosi populli dhe engjëlli vendosi pllakën e varrit, ndërsa kuaj të tërbuar i shkaktuan tiranit vdekje të tmerrshme...

Një vit më vonë vullkani i Et-nës, që ndodhet shumë afër Katanias, shpërtheu dhe lumi i zjarrtë mbërriti në qytet (251). Njerëzit vrapuan, morën mbulesën e varrit të shenjtores, bënë litani dhe llava ndaloi!

Romano-katolikët e nderojnë si mbrojtëse të Sicilisë dhe Maltës.

Agathi, greqisht = e mirë.

Meleti i Antiokisë (12 shkurt)

Filiz i pasur dhe zyrtar i Armenisë në Azinë e Vogël, në fillim të shekullit të 4-t, studioi thellë filozofinë dhe theologjinë.

Më 358 heretikët, "të Ngjashmit", e zgjodhën pasardhës të hierarkut të Sevastisë, Efstathit, të cilin e kishin shfronësuar. Por për shkak të reagimeve u tërhoq në Veria të Sirisë dhe nuk ushtroi shërbimin e tij.

Kështu, më 360, arianitet, të cilët e konsideronin të të njëjtit besim me ta, e propozuan në fronin e Antiokisë. Ranë dakord edhe orthodhoksët - marrëveshje e paparë - dhe gjithashtu e pranuan idhujtarët dhe hebrenjtë!

Por u tregua orthodhoks në fjalimin e tij gjatë fronëzimit, ku ai përdori tre gishtërinjtë e dorës për të shprehur dogmën e Trinisë së Shenjtë. Në zgjedhjen e tij, shumë aktiv ishte treguar shën Efsevi i Samosatës (22 qershor).

Heretikët pra, pasi nuk e bindën, u vunë në veprim dhe perandori Konstand (337-361) e internoi, tridhjetë ditë pas zgjedhjes së tij, në atdheun e tij, pra në Melitini të Armenisë (361). Në vend të tij u dorëzua një arianit.

Por rrezatimi i virtytit të omologjetit qetësidashës kishte krijuar shumicë "meletiane", d.m.th. luftëtarë të përkushtuar, pasues të tij. Por, pala e orthodhoksëve të rreptë nuk e njohu për shkak të propozimit të tij si kryepiskop nga arianët. Këto përfshihen në skizmën antiokiane, të quajtur jo saktë "meletiane". Jo saktë, sepse fazat e shumëllojshme të saj zgjatën një shekull e gjysmë (330-483), dhe kishte ndërthurje dhe të grupeve të tjera të nuancave të ndryshme heretike të qytetit të madh të vuajtur.

Shenjtë u kthye më 362, u internua sërish më 365, rierdhi më 367 me sa duket, për t'u dëbuar përsëri më 371 dhe të kthehet më 379. Një sinod i madh që ai mblodhi më 379, shpalli dogmën orthodhokse.

U sëmur dhe ndërroi jetë (maj 381), ndërsa kryesonte, për hir të respektit të përgjithshëm për personalitetin e tij udhëheqës, Sinodin e II Ekumenik në Konstandinopojë. U varros me nderime të veçanta.

Meleti, greqisht = studiuesi.

At Justini

Historik i shkurtër i Patrikanës Ekumenike të Konstandinopojës

Krijimi i Patrikanës Ekumenike të Konstandinopojës ka si datë viti 38 pas Krishtit, viti në të cilin u themelua Kisha e Krishterë në Bizantin antik nga Apostull Andrea, vëllai i Petrit, korifeut.

Pas themelimit të Konstandinopojës, Romës së re, që u përrua zyrtarisht si kryeqyteti i ri i perandorisë, më 11 maj 330, Patrikana mori rolin e një udhëheqjeje shpirtërore dhe promovimi të qytetërit. Shumë popuj ndjenë për shekuj të tërë ndikimin pozitiv të Patrikanës Ekumenike dhe falë punës ungjillëzuese “u ringjallën më

Krishtin”. Nën drejtimin shpirtëror të Kishës së Konstandinopojës u formuluan Kanonet e Shenjta të Kishës dhe u mbrojt besimi nga herezitë e ndryshme që e cënonin.

Selia, e saj për shekuj me radhë, ishte pranë Katedrales së Shën Sofisë, por pas rënies së Konstandinopojës në dorë të turqve u zhvendos në lagje të ndryshme të qytetit, për t’u stabilizuar përfundimisht prej vitit 1601 në lagjen e vjetër të Fanar-it.

Patrikana Ekumenike e Konstandinopojës është një nga pesë Patrikanat e vjetra të Kishës së panda-

dhokse dhe i drejton ato, shenjtëron miron për kishat e tjera lokale, u jep autonominë dhe autoqefalinë kishave lokale që plotësojnë kushtet, ka juridiksionin mbi diasporën etj.

Ekumeniciteti i Patrikanës së Konstandinopojës është përcaktuar nga dy Sinode Ekumenike: i Dyti (Konstandinopojë, 381) dhe i Katërti (Kalqedoni, 451). Të drejtat e primatit të Patriarkut të Konstandinopojës u theksuan në mënyrë solemne edhe në Sinodin e Trulllos (Konstandinopojë, 691).

Ndër shekuj Patrikana Ekumenike ka promovuar dhe zhvilluar një vepër shumë të rëndësishme misionare, që nga kthimi në krishterim i popujve sllavë në shekujt IX dhe X e deri në iniciativat misionare në Azi dhe në Amerikë.

Pas rënies së Perandorisë Otomane Patrikana Ekumenike u njoh në plan ndërkombëtar dhe ndërkristian jo vetëm si një institucion panorthodhoks, por edhe si një institucion pankristian.

Patrikana Ekumenike është një nga qendrat më aktive të lëvizjes së sotme ekumenike. Kështu p.sh. që në letren e vitit 1920 të Patriarkut Ekumenik drejtuar të gjitha kishave të krishtera, u bëhej thirrje drejtuesve të tyre “për të arritur një marrëdhënie më të afërt midis tyre”. Në dhjetëvjeçarët e fundit Patrikana Ekumenike është bërë promotore edhe e dialogjeve teologjike me të gjitha kishat e tjera të krishtera. Patrikana e Konstandinopojës zhvillon edhe një veprimtari të spikatur në mbështetje të lëvizjeve ekologjiste (Patriku Vartholomeos quhet edhe ‘Patriku i gjelbër’) dhe për paqen, duke promovuar vazhdimisht nisma për të sensibilizuar besimtarët, popujt, qeveritë dhe gjithë botën për këtë çështje themelore.

Juridiksioni i Patrikanës Ekumenike përfshin sot pesë dioqeza në Turqi. Në Greqi ka në juridiksion ishujt e Dodekanezit, Kretën, Malin e Shenjtë etj. Gjithashtu, pas emigracionit të shumë të krishterëve orthodhoksë, ka dioqeza në Evropën Perëndimore, në Amerikë, në Oqeani dhe në Azi.

Korresp. i “Ngjalljes”



Pamje nga Kisha Patriarkale e Shën Gjergjit dhe nga salla e pritjeve të Patrikanës Ekumenike



NGJALLJA

Organ i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë

Themelues: Kryepiskopi Anastas

Del nën kujdesin e Këshillit Botues

Kryeredaktor: Thoma Dhima

Adresa:

Kryepiskopata Orthodhokse, Rruga e Kavajës, Nr. 151 Tiranë

Tel: (042) 34-117, 35-095.

Fax: 32-109

Shtypur në shtypshkronjën “Ngjallja”

rë: Roma, Konstandinopoja, Aleksandria, Antiokia dhe Jerusalemi. Pas skizmës së vitit 1054, Konstandinopoja zuri vendin e parë mes katër patrikanave lindore, duke u bërë qendra shpirtërore e të gjithë Kishës Orthodhokse. Patriarku i Konstandinopojës ka titullin “Arqipiskop i Konstandinopojës - Romës së re dhe Patriark Ekumenik”. Në pozicionin e tij si “i parë midis të barabartëve” të Orthodhoksisë, Patriarku Ekumenik ndërmerr nisma të ndryshme të karakterit mbarorthodhoks, koordinon marrëdhëniet midis kishve lokale dhe raportet e gjithë Orthodhoksisë me besimet e tjera. Ai thërret Sinodet dhe Asambletë panortho-

Kalendari i Liturgjive Hyjnore, MARS 2005

5 E shtunë + E Shpirtrave. Oshd. Kononi. Konon kopshtari. Osh. Marku.

6 E DIEL + TË LIDHURIT E MISHIT. Të 42 dëshmorët e Amorit.

9 E Mërkurë + Të 40 dësh. e Sebastisë. Qesar mjeku. (*Hahet bulmet e peshk.*)

11 E Premte Sofroni i Jerusalemit. Mbret/sha Theodhora e Artës. (*Hahet bulmet e peshk.*)

12 E Shtunë + Omol. Theofani. Grigor Dialogu. Osh. Simeoni i ri.

13 E DIEL + TË LIDHURIT E DJATHIT. Transf. i lips. të Niqiforit të Kon/pojës.

14 E Hënë **E Bardhë.** Osh. Benedikti, Efsimoni. (*Fillon Kreshma.*)

16 E Mërkurë + Dësh. Savini, Juliani. Osh. Kristodhuli e Anuni, çudibërës.

18 E Premte + Qirili i Jerusalemit. Dësh. Eduardi, princ i Anglisë. (*I e Akathistit.*)

19 E Shtunë + Mrekullia e grurit nga Shën Theodhori. Dësh. Krisanthi e Daria.

20 E DIEL + I KRESHMËS (E Orthodhoksisë). Osh. varë në Manas. e Sh. Savës.

23 E Mërkurë + Dësh. Nikoni dhe 199 nxënësit e tij.

25 E Premte + # **Ungjillëzimi i Hyjllindësës (Evangelizmoi).** (*II e Akathistit.*)

26 E Shtunë + Kr/engjëlli Gavriil. Të 26 dëshmorët e Gotisë.

27 E DIEL + II KRESHMËS (Grigor Pallamai). Oshg. Matriona e Selanikut.

30 E Mërkurë + Osh. Joan sinaiti. Hierod. Zaharia. Pr. Joadi. Joani në pus.

Punimet konservuese në pikturat murale të kishës së Shën Marisë në Vrahogoranxi-Gjirokastër

Kisha e Shën Marisë në Vrahogoranxi është pikturuar në vitin 1622 nga Onufër Qiprioti dhe Alivizi. Onufër Qiprioti është një piktor i njohur i shek. XVII, i cili ka ushtruar veprimtarinë e tij edhe në qytetin e Beratit, si dhe në një numër të madh ikonash.

Territori përreth kishës është i rrethuar me mure guri dhe aty janë vendosur varrezat e fshatit. Në qoshen jugperëndimore të oborrit ngrihet kambanorja, në formën e një muri masiv mbajtës, i cili lehtësohet në pjesën e sipërme nga kambaret e kambanave.

Kisha përbëhet nga naosi dhe narteksi në anën perëndimore. Naosi i perket tipit bazilikal me kupolë.

Ndërtesa ka një shtrirje gjatësore duke u theksuar më shumë me narteksin. Hyrja nga brenda për në kishë nëpërmjet derës së vogël imponon një përkulje paksa të lehtë. Pasi hyn në naos, papritmas të shfaqet madhështi, gjë e cila nuk mund të përfytyrohet nga jashtë (kjo vjen si rrjedhojë e ndalimeve të kohës së pushtimit turk).

Kisha është ndërtuar në çerekun e parë të shek. XVII, në vitin 1622. Të dhëna të sakta për këtë jep mbishkrimi i gjendur mbi derën e faqes perëndimore të naosit, e cila tregon se kjo kishë i dedikohet "Hyjlindëses dhe gjithmonë Virgjëreshës", me mundimet dhe

shpenzimet e ONUFER QIPRIOTIT dhe ALIVIZIT, më 1622. Kjo shpreh qartë se autorët e zbulimit të të gjithë interierit janë piktorët e sipërpërmendur. Onufër Qiprioti është piktor ikonograf i njohur për krijimtarinë e tij.

Gjatë qëndrimit në qytetin e Beratit ai realizoi shumë vepra me nivel të lartë në ikona, duke e mbyllur veprimtarinë e tij në Berat më 1596, gjë për të cilën flet mbishkrimi i gjendur në një ikonë të dedikuar për një nga ikonostaset e kishave të Beratit. Më pas ai vendoset në rrethinat e Gjirokastrës, gjë e cila shënon etapën e dytë të krijimtarisë së këtij ikonografi.

Në afresket e kishës së Vrahogoranxisë duken qartë lidhjet me traditën e Beratit. Afresku është i realizuar në teknikën bizantine dhe i mbështetur mbi suport muri me një trashësi që arrin deri në 70 cm. Suvaja, e cila arrin deri në 2 cm, është e përbërë prej gëlqereje, e lidhur me kashtë të stazhionuar.

Në këtë kishë para disa vjetësh është bërë ndërhyrje restauruese si në konstruksion dhe në arkitekturë, e cila i dha fund problemeve konstruktive të rënda që kishte objekti.

Interesimi i vazhdueshëm i Kryepiskopit Anastas për të përmbyllur këtë fazë të konservimit të afreskeve murale dhe akordimi prej Tij i një fondi, bëri që Bërtha-

ma e Trashëgimisë Kulturore pranë Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë të fillojë procesin e ndërhyrjes në afresk.

Ekzaminimi arkeologjik dhe kritik i kryer gjatë projektit të restaurimit na dha mundësinë për të saktësuar ndryshimet e bëra gjatë historisë, siç ishin p.sh mbulimi i pikturës së vjetër me mbivënie si çimento, gëlqere, etj. Po kështu një rëndësi të veçantë pati ekzaminimi i shkaqeve, si ato për shkak të lagështisë, depërtimit, kapilaritetit e kondensimit, dëmtime nga mikroklima, veprimi mikrobiologjik në afreske, dëmtimet nga lëvizjet, tërmetet, zjarri, etj.

Këto shkaqe kishin sjellë si pasojë, nxirjen e pikturës me shtresëzime të shumta lyerjesh, vajërash, verniqesh e llaqesh. Tymrat e qirinjeve, kandelave e sidomos të flakëve e tymit nga diegia e amvonës së kishës kanë përzhitur, përcëlluar si dhe e kanë bërë pelikulin njësh me verniqet e llaqet, të cilat në shumë vende janë të paheqshme.

Çarjet më të mëdha viheshin në faqen jugore, veriore, perëndimore, të cilat korrespondonin me faqen lindore të narteksit. Plasuritjet e shumta të tavanit e kanë dëmtuar afreskun deri në krijimin e disniveleve të sipërfaqeve që arrijnë deri në 10 cm.

Ndërhyrjet konservuese-restauruese

Fillimisht puna u përqendrua në kupola dhe tambur, duke realizuar konsolidimin e shtresave të afreskut nëpërmjet injektiveve, mbushje të boshllëqeve me llaç special. Pas konsolidimit të saj, u bë pastrimi i pikturës nga nxirjet dhe bloza. U vu re se kupola ku ndodhet "Krishti Pantokrator" u pastrua më me lehtësi se sa faqet e tamburit. Më pas puna konservuese u përqendrua në procesin e injektiveve, qepjeve të plasaritjeve, heqjes dhe rivendosjes së afreskut. Zbulimi i afreskeve nga gëlqerja, llaçi dhe çimentoja, mbushje me llaç special e boshllëqeve.

Injektive u kryen në faqet e tamburit, në apsidë, në disa pjesë të tavanit dhe shumë vende të tjera. Gufimi i afreskut arrinte deri në 10 cm nga sipërfaqja e rrafshët e afreskut. Pas heqjes, u vu re se shkaku kryesor i këtij dëmtimi ishte dëmtimi i muraturës, lëvizja e gurëve nga degëzimet e pemëve të futura brenda muraturës në mënyrë vertikale nga poshtë-lart. Pas konsolidimit të muraturës, heqjes së degëve (bimëve), u krijua një suport i favorshëm për të rivendosur afreskun e hequr. Pas përfundimit të vendosjes, e gjithë sipërfaqja e afreskut, së bashku me të tjerat, erdhën me nivele të pëlqyeshme.

Me të njëjtin problem, pothuajse në shumë raste u ndeshëm edhe në çlirimin e plasaritjeve të mëdha të mureve nga mbushje të bëra para shumë vitesh me çimento, e cila mbulonte edhe pjesë të afreskut. Largimi i çimentos paraqiste vështirësi të mëdha dhe hera-herës ishte i pamundur, por edhe kur hiqej, dëmtonte sipërfaqen e afreskut duke lënë gjurmë dhe dëmtim. Në të gjitha rastet u bë qepje e mureve duke i plotësuar me material guri dhe me llaç të fortë dhe gëlqere.

Pjesa më e madhe e pikturës u pastrua nga pluhurat dhe bloza e krijuar prej shumë kohësh. Me këto ndërhyrje konservuese e restauruese, mendojmë se piktura murale, tashmë paraqitet në gjendje të mirë dhe jashtë rrezikut të shkatërrimit.

Përgatiti për Bërthamën e Trashëgimisë Kulturore Gentian (Joan) Stratobërdha



Pamje lindore e Kishës së Shën Marisë, Krishti Pantokrator në kupolë para dhe pas restaurimit dhe platitera në apsidë.